

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervist	Fillimi	Mbarimi
1	Inspektor	RU.Nr 6620	A-010	3-Mujore	+		01.03.2018	15.03.2018

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Inspektor
2. Kodi i pozicionit: SHP-6620-A10-C-04-003
3. Reparti/Institucioni: Rreparti Ushtarak Nr.6620 (Policia Ushtarake)
4. Vendi: A10 (Sauk, Tiranë)
5. Paga: 43 500
6. Lloji i kontratës së punës: 3- Mujore
7. Data e fillimit të aplikimit: 01.03.2018
8. Data e mbylljes së aplikimit: 15.03.2018
9. Mënyra e aplikimit: Me kërkesë
<p>10. Dokumentet e aplikimit:</p> <p>Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ kërkesën; ▪ formularin e aplikimit; ▪ fotokopje të kartës së identitetit; ▪ diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal; ▪ fotokopje të patentës nëse ka; ▪ dëshmi profesioni nëse ka; ▪ certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja ▪ raport mjekësor; ▪ fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; ▪ dëshmi penaliteti; ▪ vërtetim nga gjykata; ▪ vërtetim nga prokuroria; ▪ librezë pune; ▪ jetëshkrimin (CV). ▪ formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike eëë. mod.gov.al. (linku: <i>Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit</i>)
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: *Civil*
- b. Arsimi : *i Lartë*
- c. Kualifikimi: *të ndryshme në fushën e Juridike*
- d. Trajnimi: *Kurse/trajnime në fushen e së Drejtës*
- e. Eksperienca në Punë: *5 vjete*
- f. Gjuha e huaj: *ne nivel mesatar*
- g. Kërkesa të tjera specifike: *e pa aplikushme*
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: *Kofidencial.*

13. Përshkrimi i punës:

Inspektor i Policisë Kriminale, Përgjigjet për zbatimin e planeve operative-gjurmuese në procesin e vëzhgimit operativ ndaj subjekteve të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale, duke përgatitur planet operacional konkret sipas drejtimeve.

A. Detyrat kryesore:

- Planifikon, organizon dhe zbaton një operacion mbikëqyrje.
- Ndërmerr mbikëqyrjen e objektivave me anë të vëzhgimit fizik dhe teknik ose elektronik në situata statike, në këmbë dhe të lëvizshme.
- Në raste të jashtëzakonshme apo për nevoja operationale kryen arrestimin e individëve të dyshuar për veprimtari kriminale.

B. Detyrat shtesë:

- Të evidentojë punën e secilit agjent në sektorin e tij të vëzhgimit duke i miratuar raportin e shërbimit përkatës.
- Të përdor brenda hapësirës ligjore mjetet teknike operative gjatë procesit të përgjimit ambiantal ndaj subjekteve në vëzhgim.
- Të bashkërendoj punën me Inspektorët e Policisë Kriminale/Agjentët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore për arrestimin në flagrancë të ushtarakëve që mbahen nën vëzhgim.
- Të ruajë konfidencialitetin dhe sekretin e procesit të vëzhgimit si dhe të personelit të vetë që angazhon në detyrat operative, si dhe të mjeteve tekniko operative në përmes dekonspirimit.
- Të administroj sipas rregullave e akteve ligjore në fuqi mjetet tekniko – operative dhe të bëjë nxjerrjen e tyre në rastet e planit operacional të miratuar më parë nga Shefi i Sektorit

të Policisë Kriminale.

- Të plotësoj dokumentacionin sipas Kodit të Procedurës Penale për të dërguar fashikullin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor.
- Ushtron aktivitetin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe ndaj ushtarakëve e civilëve, vendas e të huaj, me ose pa shtetësi, që kryejnë veprime që çënojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;

d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerëson në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.